

KONTRATE-SHITBLERJE

Sot më datë 05.07.2021 u paraqitën personalisht:

PALËT:

1. **SHITËSI:** “A. TOTO”shpk, me NIPT J64102219M, ndodhur në Lagjja “Hasan”, ndërtesë 3-katëshe, pranë karburant Kastrati, Fushë-Krujë, me Administrator dhe ortak z. ANDREA TOTO, atësia Vangjel, lindur në Fushë Krujë, më 17.05.1967, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin me Nr personal G70517135C dhe ortak FREDI TOTO, atësia Vangjel, lindur më 11.12.1975, në Fushë Krujë, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin nr. 034340401, me Nr personal H51211090T. Më poshtë referuar si shitësi

2. **BLERËSI:**“FAB Construction” sh.p.k, me NIPT L22209024A, ndodhur në Rruga “Elbasanit”, White Dream Hotel, kati i parë, Tiranë, me Administrator dhe Ortak të vetëm të shoqërisë z. SHABAN XHABRAHIMI, atësia Mustafa, lindur në Tiranë, më 30.06.1965, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, pajisur me letërnjoftimin me Nr personal G50630121S. Më poshtë referuar si blerësi

Palët e mësipërme, me vullnetin e tyre të lirë ranë dakort për përpilimin e kësaj Kontrate Shitblerje si më poshtë vijon:

Baza Ligjore:

Neni 73, pika 1/b e ligjit Nr. 9901, datë 14.08.2008 “Për shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar, Neni 10 i Statutit të Shoqërisë “Grand Hotel Borsh” shpk; Kreu I – shitja e ligjit Nr. 7850, datë 29.02.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Të Dhëna Paraprake:

Shoqëria “Grand Hotel Borsh” shpk, e pajisur me NIPT M01414027F, themeluar në 11.02.2020, me seli në Rruga e Plazhit, Vlore, Himare, Nr. 168/25, ZK 1253, Borsh, ka dy ortakë

respektivisht: “A. TOTO”shpk që zotëron 49% të kuotave dhe :“FAB Construction” sh.p.k që zotëron 51% të kuotave.

1. Objekti i Kontratës së Shitjes:

Pala shitëse i shet palës blerëse 19% të kuotave që zotëron në shoqërinë Grand Hotel Borsh, me NIPT M01414027F, me adresë Rruga e Plazhit, Vlore, Himare, Nr. 168/25, ZK 1253, Borsh.

2. Cmimi i Shitjes dhe Mënyra e Pagesës

Palët deklarojnë se Shitësi, pasurinë e mësipërme ia shet Blerësit kundrejt cmimit në shumën 19.000 (nëntëmbëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me vlerën e regjistruar të kuotave në kapitalin e shoqërisë (1 kuotë = 1000 Lekë).

Palët deklarojnë se Blerësi do të likujdojë plotësisht cmimin e shitjes së pronës, duke e transferuar shumën prej 19.000 (nëntëmbëdhjetë mijë) lekë në llogarinë bankare të Shitësit me të dhëna:

BKT Bank

IBAN ALL: AL3820513236245389CL PRCL ALLA

SWIFT: NCBAALTX

3. Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat


Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga shitësi tek blerësi do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe regjistrimit të saj në QKB

4. Rregjistrimi në QKB

Ngarkohet shoqëria “Grand Hotel Borsh” shpk për të kryer regjistrimin e kësaj kontrate në QKB, menjëherë pas nënshkrimit të saj.

5. Të drejta dhe detyrimet e paleve

Shitësi detyrohet të njoftojë blerësin mbi disponimin e gjithë dokumentacionit orgjinal të akteve themeluese, të akteve të tatimeve, si dhe cdo dokumentacion tjetër që është i nevojshëm për t’u dorëzuar.



2

Blerësi, këtë kontratë shitje kuotash bashkë me dokumentacionin përkatës, ta depozitojë në zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë QKB-së, Tiranë, si dhe të njoftojë ndryshimin e pronësisë mbi/për kuotat e shoqërisë “Grand Hotel Borsh” shpk, në Zyrën e Tatim Taksave Vendore dhe në cdo institucion tjetër që është e nevojshme.

6. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

7. Redaktimi dhe hyrja në fuqi e kontratës

Kjo kontratë e shitjes së kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “Grand Hotel Borsh” shpk, përpilohet në tre kopje autentike në gjuhën shqipe.

Kjo kontratë hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga palët.

Kontratës së Shitblerjes i bashkëlidhet:

1. Ekstratet e shoqërive
2. Id e Ortakëve

PALËT

SHITËSI

A.TOTO shpk

Administrator

Andrea TOTO

Andrea TOTO

Ortak

Fredi TOTO

Fredi TOTO



BLERËSI

FAB CONSTRUCTION shpk

Administrator

Shaban XHABRAHIMI

Shaban Xhabraimi

FAB CONSTRUCTION Sh.p.k.
NUIS: L 22209024 A
Tirane - Albania